



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:027467
Datë: 04.04.2024
Numri i dokumentit: 05541600

E.nr.551//23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorëve: A.A., F.F., B.S., A.K. dhe I.Th.B., të cilët i përfaqëson av Arian Hetemi nga Lipjani, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e ushqimit, shpenzimet e udhëtimit, shpërblimit jubilar, si dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 02.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.551/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.551/23, të datës 23.03.2023, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e pagesën e ushqimit, shpenzimet e udhëtimit, shpërblimi jubilar dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjyqimit C.nr.405/20, të datës 06.12.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 15.09.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 11,101.41 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.551/23, më datë 02.04.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi